



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT KOMUNA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-0 / DPK
Dep.	Nr. Prot.
Dep.	Br. Prot.
Nr. I faq.	Prot No.
Broj stranica	01-4807/15
Nr. pages	02
Data	
Datum	
Date 17.12.2015	
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (parografi 1.1), nenit 5 (parografi 1 pika 1.5), nenit 18 (parografi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (parografi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 17.12.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me nr. AKK- 03-02-3969/15, për z. Arif Butuç – Kryetar i Komunës së Mamushës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihaqet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, për z. Arif Butuç – Kryetar i Komunës së Mamushës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë z. Butuç është hetuar për konflikt interesit sepse krahas funksionit publik të zyrtarit të lartë publik, ka qenë pronar i vetëm në biznesin privat N.P.T. “Derya”.

Agjencia kundër Korrupsionit fillimisht zyrtarit i ka dërguar shkresën zyrtare me të cilën e ka njoftuar për fillimin e procedurës për shqyrtimin e konfliktit të interesit, pas së cilës ai ka kontaktuar zyrtarët e Agjencisë.

z. Butuç është njoftuar me kufizimet në ushtrimin e funksioneve tjera, krahas ushtrimit të funksionit publik dhe për ndryshimet që duhet të bëj për të shmangur konfliktin e interesit. Ai ka premtuar që në afat sa më të shpejt do caktoj një person të autorizuar në biznesin privat në mënyrë që të shmang konfliktin e interesit.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilën vërtetohet se ka caktuar një person të autorizuar për të menaxhuar biznesin privat. Me këtë zyrtari i lartë kashmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (parografi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./zpj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

* Hasan Preteni *

